

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURËS, MËNYRËS SË TRANSFERIMIT TË MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË PESHKIMIT DHE INFRASTRUKTURËS SË LIDHUR ME PESHKIMIN DHE TË FORMATIT TIP TË KONTRATËS

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi ka për qëllim përcaktimin e kriterëve, procedurës, mënyrës së transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe miratimin e kontratës tip që do të lidhet midis institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës dhe palës tjetër sipas rastit.

Aktualisht procedura e transferimit të infrastrukturës së peshkimit rregullohet nga Vendimi nr. 347/2019 i Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit të organizatave të peshkimit, njësitë e qeverisjes vendore dhe subjektet private”*. Por, me ndryshimet që pësoi Ligji nr. 64/2012 *“Për peshkimin”*, në vitin 2024, u parashikuan disa ndryshime në dispozitat që prekin infrastrukturën e peshkimit dhe infrastrukturën e lidhur me peshkimin. Rrjedhimisht u parashikua dhe autorizimi ligjor neni 65, pika 4, e Ligjit nr. 64/2012, sipas të cilit përcaktimi i kriterëve, procedura, mënyra e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe formati tip i kontratës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky projektvendim thjeshtëzon, saktëson dhe qartëson zbatimin e procedurave në rast të transferimit të infrastrukturës së peshkimit dhe atë të lidhur me peshkimin nga institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës tek organizata e peshkimit, njësia e vetëqeverisjes vendore dhe tek subjektet private.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2026 për katërmujorin e parë për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me ndryshimet e Ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, në vitin 2024 u parashikuan disa ndryshime në dispozitat që prekin infrastrukturën e peshkimit dhe të lidhur me peshkimin.

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, aktualisht Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA) është institucion varësie i MBZHR-së i cili, sipas Vendimit nr. 613/2017, të Këshillit të Ministrave ka në përdorim asetet e lidhura në fushën e peshkimit dhe akuakulturës. Sipas ndryshimeve ligjore institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës menaxhon në mënyrë të drejtpërdrejtë infrastrukturën e peshkimit dhe atë të lidhur me peshkimin ose kryen procedurat e transferimit të menaxhimit të tyre.

Në rastin e pamundësisë së menaxhimit të drejtpërdrejtë të infrastrukturës së peshkimit dhe të lidhur me peshkimin, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës do të kryejë procedurat e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe të lidhur me peshkimin. Infrastruktura e peshkimit përfshin portet, qendrat e peshkimit, vendzbatimet dhe tërësinë e trojeve, kalatave, godinave, përfshirë muret rrethuese të porteve dhe akuatoriumin, instalimet e sinjalizimit, të ndriçimit dhe të komunikimit. Ndërsa infrastruktura që lidhet me peshkimin përfshin markatat, tregun e shitjes me shumicë, linjat teknologjike, asetet e lidhura, shkallët e riparimit të anijeve të peshkimit, depozitat e karburantit, pasuritë e luajtshme dhe çdo pasuri ose objekt tjetër që i shërben peshkimit. Në rast të pamundësisë së menaxhimit të drejtpërdrejtë nga DSHPA, infrastruktura e peshkimit mund t’i transferohet për menaxhim një organizate peshkimi të njohur nga ministri, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 64/2012. Organizatat e peshkimit mund të krijohen në formën e një organizate menaxhimi peshkimi, kooperativave ose organizatave të prodhuesve.

Ndërkohë, menaxhimi i infrastrukturës së lidhur me peshkimin në rast pamundësie të menaxhimit të drejtpërdrejtë nga DSHPA, transferohet te njësi e vetëqeverisjes vendore, nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet kjo infrastrukturë e lidhur me peshkimin dhe në rast se njësi e vetëqeverisjes vendore nuk shpreh interes për menaxhimin e infrastrukturës së lidhur me peshkimin, kjo infrastrukturë u transferohet me konkurrim publik subjekteve tregtare.

Me qëllim përcaktimin e kriterëve, procedurave, mënyrave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe formatin tip të kontratës, sipas parashikimeve të nenit 65, pika 4, të Ligjit nr. 64/2012, kërkohet miratimi i një vendimi të Këshillit të Ministrave.

Miratimi i këtij projektvendimi sjell këto përparësi kryesore:

- Përcaktimin e qartë të kriterëve, procedurës dhe mënyrës së transferimit të menaxhimit për të gjitha kategoritë përfituese (organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet tregtare);
- Rritjen e transparencës dhe konkurrencës në procesin e transferimit, nëpërmjet procedurave të shpallura publikisht;
- Standardizimin e marrëdhënieve kontraktore përmes miratimit të një formati tip kontrate;
- Përmirësimin e menaxhimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës, duke nxitur investimet dhe mirëmbajtjen e saj;
- Fuqizimin e rolit të organizatave të peshkimit dhe të njësisë të vetëqeverisjes vendore në administrimin e infrastrukturave.
- Vendosjen e mekanizmave të qartë për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të kontratave.

Zbatimi i këtij projektvendimi pritet të ketë këto efekte:

- Rritjen e eficiencës në administrimin e infrastrukturës së peshkimit dhe të lidhur me të;
- Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për operatorët e sektorit të peshkimit;
- Nxitjen e zhvillimit ekonomik të sektorit dhe rritjen e të ardhurave nga shfrytëzimi i infrastrukturës;
- Garantimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të përdorimit të qëndrueshëm të aseteve;
- Rritjen e investimeve në infrastrukturë dhe përmirësimin e kushteve teknike dhe funksionale të saj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi hartohet në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe me nenin 65, pika 4, të Ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* E BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me *acquis* e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është i përbërë nga 7 krerë:

Kreu i parë përcakton dispozitat e përgjithshme mbi procedurën e transferimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin.

Kreu i dytë përcakton rregullat për procedurën e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit pa konkurrim. Procedura e transferimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizata e menaxhimit të peshkimit e njohur nga ministri, në rastin kur infrastruktura e peshkimit ndodhet në një zonë bashkëmenaxhuese, transferohet tek OMP-ja në fjalë pa konkurrim.

Kreu i tretë përcakton rregullat për procedurën e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit me konkurrim.

Në rast se ka më shumë se një organizatë peshkimi në të njëjtën zonë, procedura e transferimit zhvillohet nëpërmjet konkurrimit nga insitucioni përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën. Procedura kryhet online në portalin unik qeveritar e-Albania nga DSHPA, nëpërmjet ngritjes së një *komisioni ad hoc* që shqyrton dokumentacionin sipas kritereve të vendosura. Organizata e peshkimit zbaton kushtet e vendosura nga neni 64, i Ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, duke garantuar mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit, ruajtjen dhe garantimin e interesit publik, ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të infrastrukturës së peshkimit, që i është dhënë në menaxhim.

Kreu i katërt parashikon, përcakton rregullat për procedurën e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin tek njësitë e vetëqeverisjes vendore. Menaxhimi i infrastrukturës së lidhur me peshkimin i transferohet njësite të vetëqeverisjes vendore nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet kjo infrastrukturë e lidhur me peshkimin. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës kërkon miratimin paraprak nga ministri që infrastruktura e lidhur me peshkimin t'i propozohet për menaxhim njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse. Pas konfirmimit nga ministri, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturën i drejtohet me shkresë zyrtare njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, duke i propozuar menaxhimin e infrastrukturës së lidhur me peshkimin, në fjalë. Propozimi përmban kriteret e transferimit të menaxhimit. Njësia e vetëqeverisjes vendore merr përsipër përballimin e kostove të përdorimit dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturës së lidhur me peshkimin, përfshirë edhe taksat e aplikueshme nga legjislacioni në fuqi dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture.

Kreu i pestë parashikon, përcakton rregullat për procedurën e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin tek subjektet private me konkurrin publik, në rastet kur njësia e vetëqeverisjes vendore, në juridiksionin e së cilës ndodhet infrastruktura, nuk shpreh interes për administrimin e saj.

Transferimi realizohet përmes një procesi konkurrues publik, ku përzgjedhja e subjektit fitues bazohet në disa kriteret kryesore, si: përputhshmëria e aktivitetit me legjislacionin për peshkimin, niveli i investimeve të propozuara për përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve higjieno-sanitare, plani për sigurinë e objektit, cilësia e shërbimit, kostot operative, niveli i punësimit dhe oferta për detyrimin mujor të qirasë.

Pas marrjes së miratimit nga ministri përgjegjës për peshkimin, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës harton dhe publikon njoftimin për konkurrin në buletinin e njoftimeve publike dhe në faqen zyrtare të Ministrisë, duke përcaktuar të dhënat për objektin dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim. Ky institucion përgatit gjithashtu dokumentacionin shoqëruar, i cili përfshin, ndër të tjera, propozimin për dhënien me qira, genplanin e objektit, tarifën dysHEME të qirasë dhe dokumentacionin për pronësinë. Procesi i aplikimit dhe dorëzimit të dokumenteve kryhet në mënyrë elektronike përmes portalit "e-Albania". Subjektet paraqesin formularin e ofertës, plan-biznesin dhe një deklaratë për përgjegjësinë ligjore mbi saktësinë e të dhënave.

Për vlerësimin e aplikimeve ngrihet një komision me tre anëtarë (jurist, ekonomist dhe specialist i fushës), i cili shqyrton dokumentacionin dhe vlerëson plan-biznesin sipas kritereve të përcaktuara, duke përfshirë investimet, sigurinë, cilësinë e shërbimit dhe kostot operative. Subjekti privat garanton mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit, ruajtjen dhe garantimin e interesit publik, ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të infrastrukturës së lidhur me peshkimin që i është dhënë me qira.

Kreu i gjashtë parashikon rregullat e monitorimit të kontratave. Monitorimi i kontratës për transferimin e infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin tek njësitë e vetëqeverisjes vendore apo subjekteve private bëhet nga institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.

Kreu i shtatë parashikon mënyrën e përdorimit të të ardhurave nga menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin.

Kreu i tetë parashikon dispozitat e fundit dhe hyrjen në fuqi.

Gjithashtu, projektvendimi shoqërohet me tre shtojca që përcaktojnë formatin tip të kontratës që do të lidhet midis institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës dhe organizatave të peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose subjekte private.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Projektvendimi është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit shprehet parimisht dakord me sugjerimin që, lidhur me parashikimin që objektet në funksion të lejeve të peshkimit përjashtohen nga konkurrimi kur u jepen me qira subjekteve të pajisura me leje shfrytëzimi në fushën e peshkimit, të mbahet në konsideratë që, në zbatim të shkronjës c, pikës 5, të kreut I, të VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014, “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, dhe të Udhëzimit nr. 13/2018, institucioni që monitoron lejen e peshkimit vijon

procedurën për lidhjen e kontratës së qirasë vetëm kur sipërfaqet dhe objektet kërkohen në ndihmë të aktivitetit për të cilin subjekti është pajisur me leje. Sugjerimi i bërë do të jetë në vëmendje gjatë kryerjes së procedurave për dhënien pa konkurrim të objekteve në funksion të lejeve të peshkimit.

Ministria e Drejtësisë është shprehur me disa komente si më poshtë vijon:

Lidhur me komentet e bëra në pikën 1, ku sugjerohet të shmanget përdorimi i lidhëzës dhe/ose, ky sugjerim është mbajtur parasysht në parashikimet e bëra në projektvendim dhe është bërë i qartë në kreun I, cili është roli i ministrit dhe i institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës në procedurat e transferimit.

Konkretisht, është përcaktuar që ky institucion menaxhon në mënyrë të drejtpërdrejtë infrastrukturën e peshkimit dhe të lidhur me peshkimin ose kryen procedurat e transferimit të menaxhimit të tyre, me miratim të ministrit.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 2, ku sugjerohet që rregullimet ligjore të bëra në pikat 3-9, të kreut I të projektvendimit, që lidhen me procedurat e mirëfillta të transferimit, të jenë pjesë integrale e krerëve ku janë parashikuar procedurat përkatëse, ky sugjerim është marrë në konsideratë. Krerët janë ripunuar, duke pasur në vëmendje këtë sugjerim. Gjithashtu, është bërë i qartë edhe roli i ministrit në procedurat e transferimit. Ministri, në cilësinë e autoritetit përgjegjës administrues, vlerëson dhe autorizon transferimin e menaxhimit të këtyre infrastrukturave.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 3, ku sugjerohet të specifikohen kriteret e transferimit që vlerësohen nga ministri, sqarojmë se ky sugjerim është reflektuar në krerët përkatës, në kuadër të parashikimeve për procedurat respektive. Këto kriteret përcaktohen nga institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 4, ku sugjerohet të specifikohet nëse OP, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet tregtare bëjnë propozim, kërkesë apo marrin iniciativë për nisjen e procedurave të transferimit dhe të unifikohet përdorimi i të njëjtit term, ky sugjerim është marrë në konsideratë, duke përcaktuar qartë në krerët përkatës.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 6, ku sugjerohet të specifikohen dokumentet që përbëjnë dokumentacionin e procedurës së transferimit, të cilat i dërgohen ministrisë përgjegjëse për peshkimin, sqarojmë se krerët janë ripunuar dhe se roli i ministrit është vetëm në fillim të nisjes ose jo të procedurës. Më pas është DSHPA që kryen të gjithë procedurën e transferimit.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 7, ku sugjerohet që të specifikohet vendimi i Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës si zonë bashkëmenaxhuese”, sqarojmë se ky sugjerim nuk është marrë parasysh, pasi ka disa zona bashkëmenaxhuese dhe shpallja e këtyre zonave nuk realizohet me një vendim të vetëm, por nëpërmjet vendimeve të veçanta të Këshillit të Ministrave, të miratuara rast pas rasti për secilën zonë. Megjithatë, pika 1 është riformuluar për ta bërë më të qartë.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 8, ku sugjerohet që të hiqen pikat 11 dhe 13, të kreut II të projektvendimit, ky rekomandim është reflektuar gjatë ripunimit të kreut II.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 9, ku sugjerohet që procedurat e transferimit tek të gjithë subjektet përfitues (OP, OMP, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet tregtare) të përcaktohen në këtë projektvendim dhe jo të bëhet referencë të VKM-së nr. 54/2014, ky sugjerim është marrë parasysh.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 10, ku sugjerohet të specifikohen kriteret e transferimit që vlerësohen nga ministri, sqarojmë se projektvendimi është ripunuar, kriteret janë përcaktuar dhe vlerësohen nga DSHPA.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 11, ku sugjerohet të parashikohet një afat për korrigjimin e mangësive në dokumentacionin e vlerësuar nga komisioni, në rastet kur ky dokumentacion rezulton i paplotë, i paqartë apo i ndryshëm nga kërkesat e përcaktuara, sqarojmë se ky sugjerim është reflektuar në kërkesat përkatës.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 12, ku sugjerohet që të saktësohet nëse krijimi i regjistrit për të dhënat dhe për të ardhurat nga përdorimi i pasurisë shtetërore transferuar tek të tretët është në kushtet e nenit 4, të Ligjit nr. 10325/2010, ky sugjerim është pasqyruar në relacion tek përmbledhja shpjeguese e përmbajtjes së aktit.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 13, ku sugjerohet që hartimi i projektvendimit të bëhet në përputhje me pikën 2, të nenit 45, të Udhëzimit nr. 6/2022, të ministrit të Drejtësisë, sqarojmë se ky sugjerim është marrë parasysh, duke u ripunuar drafti në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë dispozitë.

Lidhur me komentet e bëra në pikën 14, ku sugjerohet që përmbajtja e relacionit shpjegues të rishikohet dhe të përpunohet tërësisht, duke përfshirë argumenta të plota, të qarta dhe konkrete në mbështetje të ndryshimeve të propozuara në projektvendim, si dhe të saktësohen arsyet specifike për të cilat kërkohet ndërhyrja legjislative, ky sugjerim është reflektuar.

Ministria e Financave është shprehur parimisht dakord.

Duke qenë se ky projektvendim është i ripunuar tërësisht, nevojitet të dërgohet sërish për mendim në MD, MF, MEI, MSHPV dhe Këshill Konsultativ Qeverisje Qendrore dhe Vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

MINISTËR

Andis Salla



The image shows a handwritten signature in black ink, which appears to be 'Andis Salla', written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BUXHETI DHE ZHVILLIMI RURAL' around the perimeter and 'MINISTRIA E BUXHETIT DHE ZHVILLIMIT RURAL - TIRANË' at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.